

VENDIM
Nr. 238, datë 30.3.2016

**PËR PAGIMIN E INTERESAVE TË VONESAVE NË EKZEKUTIMIN E DISA
VENDIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pagesën e interesave të thjeshta për vonesat në ekzekutimin financiar të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas pikës 2 të këtij vendimi.

2. Interesat e thjeshta të vonesës do të llogariten nga data e afatit përfundimtar për shlyerjen e detyrimit deri në datën e urdhërpagesës së principalit të detyrimit, si më poshtë vijon:

- Për çështjen "Caka kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 44023/02), interesat do të llogariten nga data 8.6.2010.

- Për çështjen "Bushati dhe të tjerë kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 6397/04), interesat do të llogariten nga data 14.8.2012.

- Për çështjen "Alimuça kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 20134/05), interesat do të llogariten nga data 9.10.2012.

- Për çështjen "Canli kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 11006/06), interesat do të llogariten nga data 6.9.2012.

- Për çështjen "Izet Haxhia kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 34783/06), interesat do të llogariten nga data 5.5.2014.

- Për çështjen "Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 609/07), interesat do të llogariten nga data 22.2.2011.

- Për çështjen "Mullai dhe të tjerë kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 9074/07), interesat do të llogariten nga data 18.4.2012.

- Për çështjen "Gjyli kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 32907/07), interesat do të llogariten nga data 29.3.2010.

- Për çështjen "Kaçiu kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 33192/07), interesat do të llogariten nga data 9.3.2014.

Për çështjen "Cale kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 50933/07), interesat do të llogariten nga data 6.2.2013.

- Për çështjen "Themeli kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 63756/09), interesat do të llogariten nga data 15.4.2013.

- Për çështjen "Tushaj kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 13620/10), interesat do të llogariten nga data 15.4.2013.

- Për çështjen "Rrapo kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 58555/10), interesat do të llogariten nga data 25.3.2013.

3. Interesat e thjeshta të vonesës janë të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind, mbi shumat e urdhëruara nga vendimet përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

4. Vlerat e detyrimit, të llogaritura sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3, të këtij vendimit, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës, ku do të depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

5. Vlerat e llogaritura si detyrim, sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3, të këtij vendimi, të

konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës, ku do të depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

6. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama